


FLETË FAKTESH

Njësia për Monitorimin e Rasteve e Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) bënë vlerësimin e funksionimit të gjyqësorit dhe policisë së Kosovës për nga aspekti i përputhshmërisë procedurale, **ligjore** dhe **të drejtave të njeriut**. Vlerësimi kryhet përmes monitorimit **sistemik** dhe **tematik** të rasteve të zgjedhura **penale** dhe **civile**, përfshirë raste që më parë janë shqyrtuar nga EULEX-i deri në qershor 2018 në kuadër të mandatit të tij të kaluar ekzekutiv.

Monitorimi mbulon tërë zinxhirin e sistemit të drejtësisë penale (**policia, prokuroria** dhe **gjykatat**) si dhe aspekte të sistemit të drejtësisë civile. Nga janari 2019 – pas përfundimit në dhjetor 2018 të dorëzimit të dosjeve të rasteve policore, prokuroria dhe gjyqësore tek autoritetet e Kosovës – deri në shtator 2020, monitoruesit e EULEX-it në drejtësi kanë vijuar **686 seanca dëgjimore**, ku përfshihen raste të profilit të lartë, raste të krimeve të luftës, raste të dhunës në bazë gjinore, krime të urrejtjes, raste të korrupsionit, dhe raste të cilat EULEX-i i ka pasur nën shqyrtim në të kaluarën.

Kjo ka rezultuar me katër raporte me gjetje dhe rekomandime për autoritetet e Kosovës, e të cilat kanë për qëllim identifikimin e mangësive për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.



EULEX-i tani është duke i monitoruar 248 raste

Vështrim mbi Raportin e EULEX-it nga Monitorimi në Drejtësi

Periudha: Shtator 2019 deri në mesin e marsit 2020
Stafi i EULEX-it ka monitoruar 107 raste dhe 312 seanca dëgjimore

MONITORIMI SISTEMIK

Çështjet e identifikuara përmes monitorimit me dimension sistematik

Seancat dëgjimore produktive vs. joproduktive

Gjetjet	Rekomandime
<p>Trend i vazhdueshëm i më pak seancave dëgjimore joproduktive. Prej 287 rasteve të monitoruara, 67 ishin joproduktive pra 23% krahasuar me 29% në periudhën e mëparshme të raportimit. Arsyeja kryesore e seancave dëgjimore joproduktive ishte mungesa e të pandehurit (36%).</p>	<p>Prokurorët duhet të mbahen përgjegjës nëse mungojnë apo paraqiten të papërgatitur pa arsye të justifikueshme.</p> <p>Gjyqtarët duhet të raportojnë rregullisht për numrin e seancave dëgjimore joproduktive dhe për masat e ndërmarra.</p> <p>Gjyqtarët duhet t'i aplikojnë masat ndëshkuese dhe disiplinore sipas Kodit të Procedurës Penale.</p>

Progresi në rastet e profilit të lartë

Gjetjet	Rekomandime
<p>Një progres i bërë në ritmin e gjykitimit të rasteve të profilit të lartë. Megjithatë, një numër i rasteve të profilit të lartë ka vazhduar të jetë joaktiv.</p>	<p>Gjykatat duhet të sigurojnë që seancat e gjykimeve të mos vonohen pa arsye.</p>

Ndjekja penale e rasteve të terrorizmit

Gjetjet	Rekomandime
<p>Përpjekje të vazhdueshme për ndjekjen penale të qytetarëve të kthyer nga vatrat e luftës në Siri.</p> <p>Ndarje e shpejtë e drejtësisë.</p> <p>Dënime relativisht të ulëta apo me kusht.</p>	<p>Meqë barra e menaxhimit të rreziqeve të mundshme në të ardhmen që lidhen me të kthyerit bie mbi policinë, institucionet e Kosovës për sundim të ligjit duhet t'i monitorojnë rezultatet nga afër.</p>

Politika e rigjytimeve

Gjetjet	Rekomandime
<p>Një numër relativisht i lartë i rasteve kthehen nga Gjykata e Apelit në gjykatat themelore përkatëse për rigjykim.</p> <p>Udhëzimet nëpër vendimet e Gjykatës së Apelit për urdhërimin e rigjytimeve nganjëherë nuk janë mjaftueshëm precize dhe lënë vend për interpretime.</p> <p>Ka vonesa të shumta për hartimin dhe dorëzimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit për urdhërimin e rigjykitimit.</p> <p>Disa aktgjykime për rigjytime të nxjerra nga Gjykatat Themelore nuk pasqyrojnë mjaftueshëm administrimin e provave nga rigjykimi, por kryesisht bazohen në aktgjykimet fillestare.</p>	<p>Gjykata e Apelit duhet t'i shmangen anulimit të panevojshëm i aktgjytimeve.</p> <p>Gjykata e Apelit duhet të përmbahet nga kthimi i panevojshëm i rasteve për rigjykim.</p> <p>Rigjykimi duhet të përdoret rrallë meqë ai prekë mbi të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë brenda një periudhe kohore të arsyeshme.</p> <p>Cilësia e aktgjytimeve duhet të përmirësohet, me fokus specifik në nevojën për harmonizim më të mirë të dispozitivëve dhe pjesës së arsyetimit të aktgjytimeve.</p>

Caktimi i rasteve në procedura të rigjykitimit

Gjetjet	Rekomandime
<p>Gjykatat Themelore i caktojnë rastet që kthehen për rigjykim tek kryetari i trupit gjykoës apo trupi gjykoës i njëjtë. Ndonëse mund të jetë diçka pozitive nga aspekti i efikasitetit, kjo ngritë shqetësime rreth paanshmërisë së gjyqësorit.</p>	<p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të vlerësojë praktikën aktuale gjyqësore dhe implikimet e saj.</p>

Praktikat e pyetjeve të tërthorta nëpër gjytime

Gjetjet	Rekomandime
<p>Zbatim jokonsistent i parimeve të pyetjeve të tërthorta.</p> <p>Përgatitje jo e duhur e palëve përgjegjëse për pyetje të tërthorta.</p> <p>Shumica e pyetjeve të bëra nga palët ishin përtej fushëveprimit të pyetjeve të tërthorta duke rezultuar me zgjatjen e procedurave penale.</p> <p>Vërejtjet e paraqitura nga palët kundërshtuese shpesh kanë qenë shpesh të paqarta dhe/apo të pabazuara, çka ka rezultuar me vonesa të panevojshme.</p> <p>Nganjëherë, janë lejuar nga disa raunde të pyetjeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta, në kundërshtim me dispozitat.</p>	<p>Gjyqtarët duhet të kujdesen për aplikimin e ligjshëm të rregullave për pyetjet e tërthorta përgjatë zhvillimit të seancave kryesore të gjykimeve.</p> <p>Palët kanë përgjegjësitë e vet për zbatimin e duhur të pyetjeve të tërthorta.</p>

Shpallja e aktgjytimeve penale në shkallë të parë

Gjetjet	Rekomandime
<p>Ka disa mospërputhje në praktikën e shpalljes së aktgjytimeve. Për shembull, nganjëherë vepra penale nuk lexohet me zë; dhënia e një arsytimi të shkurtë është lënë tërësisht anash apo ai ka qenë i pamjaftueshëm; palëve nuk i janë dhënë udhëzime për mjetet juridike; shpalljet kanë qenë të pamjaftueshme nga fakti se gjyqtarët nuk janë dëgjuar apo kuptuar.</p>	<p>Ka nevojë për trajnime më efektive për gjyqtarët.</p>

Paraburgimi

Gjetjet	Rekomandime
<p>Duket se ka mbështetje të tepërt në masën e sigurisë së paraburgimit.</p> <p>Në disa raste paraburgimi ka patur efektin e zëvendësimit të ndonjë dënimi eventual, jashtë fushëveprimit të seancës kryesore të gjykitimit, çka është shqetësuese për nga perspektiva e të drejtave të njeriut.</p>	<p>Kërkesat e prokurorisë për caktimin e paraburgimit dhe vendimet përkatëse të gjykatës duhet të arsyetohen me fakte konkrete në atë mënyrë që i pandehuri të jetë në gjendje ta kuptojë vendimin.</p> <p>Në rast se plotësohen kushtet për caktimin e një mase sigurie, duhet të urdhërohet masa më e butë kurse paraburgimi duhet të jetë mjeti i fundit.</p>

Konfiskimi dhe konfiskimi i përkohshëm i pasurisë

Gjetjet	Rekomandime
<p>Fakti se prokuroria shpesh përdorë konfiskimin e përkohshëm të asetëve është diçka që është vërejtur me pozitivitet.</p> <p>Shitja e parashikuar e pasurive gjatë procedurave, e propozuar nga prokuroria për shmangien e humbjes së vlerës, nuk gjen miratim të gjerë nga gjykatat.</p> <p>Ligji i vitit 2019 për kompetencat e zgjeruara ende nuk është zbatuar.</p>	<p>Të fillohet zbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë.</p> <p>Të përdoret më shpesh mundësia e shitjes së pasurive.</p>

Funksionimi i Departamentit Special në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit në Prishtinë

Gjetjet	Rekomandime
<p>Fakti i funksionalizimit të tij ka patur ndikim pozitiv mbi efikasitetin e sistemit gjyqësor.</p> <p>Vendimi për mosorganizimin e gjyqtarëve nëpër trupe gjyqësore fikse me tre gjyqtarë të njëjtë është pozitiv dhe në pajtueshmëri me rekomandimin e mëparshëm të EULEX-it.</p>	<p>Të rritet numri i gjyqtarëve në pajtim me dispozitat ligjore për diversitetin etnik.</p> <p>Të bëhet punësimi i stafit mbështetës dhe të rritet numri i përkthyesve për gjuhët shqip/serbisht.</p> <p>Të vihen në zbatim pajisjet e nevojshme për mundësimin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve nën masa mbrojtëse në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë.</p>

MONITORIMI TEMATIK

Anti-korrupsioni

Gjetjet	Rekomandime
<p>Task Forca e Policisë së Kosovës ka zbuluar dhe ndërmarrë hetime të profilit të lartë që përfshijnë persona të njohur dhe të ekspozuar politikisht, si dhe raste të ndërlikuara financiare, siç janë ato që ndërlidhen me privatizime apo tenderë publikë.</p> <p>Riorganizimi i PSRK-së ka rezultuar në përpjekje të përqendruara për trajtimin e korrupsionit të shkallës së gjerë.</p> <p>Niveli i bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes policisë dhe prokurorisë vazhdon të jetë shqetësues.</p> <p>Disa gjetje sugjerojnë transparencë dhe llogaridhënie të pamjaftueshme nga prokuroria apo ngurrin për përbushjen e rolit mbikëqyrës të saj.</p> <p>Një numër i rasteve që përfshijnë zyrtarë të profilit të lartë kanë ngecur apo shënuar regres.</p>	<p>Bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë për rastet e korrupsionit dhe krimeve financiare të rënda të ndjeshmërisë së caktuar, duhet të përmirësohet.</p> <p>Ndonëse shumë hetime janë zhvilluar me profesionalizëm, hetimet financiare të ndërlikuara do të përfitonin prej hetimeve më të fuqishme. Pistat që janë në dispozicion nuk eksplorohehen gjithmonë, siç janë skemat kyçe financiare dhe regjistrat e korporatave.</p> <p>Parimi “ndiq paratë” ka nevojë të fuqizohet me rastin e hetimeve të krimeve të pastrimit të parave dhe krimeve financiare.</p> <p>Task Forca Anti-Korrupsion e Policisë së Kosovës duhet të fuqizohet.</p>

Krimet nga e drejta ndërkombëtare

Gjetjet	Rekomandime
<p>Me mbështetjen e EULEX-it, Njësia e Policisë së Kosovës për Hetimin e Krimeve të Luftës ka krijuar një databazë të re për një administrim më të mirë të rasteve të ndërlikuara dhe analizim më cilësor të rasteve. Databazat përbëjnë pjesë të ndara për rastet e dhunës seksuale të ndërlidhura me konfliktin, dhe për rastet e personave të pagjetur. Databaza mundëson verifikimin e ndërthurit të dosjeve të krimeve të luftës dhe dosjeve të personave të pagjetur, që do të lehtëson dhe përshpejton dukshëm procesin e përgatitjes së rastit.</p> <p>Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës ka përfunduar hetimet në shumicën e rasteve aktive të krimeve të luftës.</p> <p>Hetimet e zhvilluara nga Policia e Kosovës në rastet e krimeve të luftës të cilat janë kategorizuar nga PSRK-ja si me prioritet të lartë nuk kanë shënuar progres të mjaftueshëm.</p> <p>Departamenti i PSRK për Krime të Luftës, ndonëse me numër të pamjaftueshëm të stafit, ka shënuar progres domethënës dhe ka finalizuar pothuajse të gjitha rastet e saj aktive të krimeve të luftës qoftë përmes ngritjes së aktakuzave apo ndërprerjes së hetimeve.</p> <p>Ka raste kur seancat kryesore të gjyqësorëve kanë shkuar përtej çdo afati kohor të arsyeshëm.</p>	<p>Policia e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për vazhdimin e hetimeve dhe analizimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës të kategorizuara me prioritet të lartë.</p> <p>Ndonëse bashkëpunimi mes Departamentit të PSRK për Krime të Luftës dhe Policisë së Kosovës është përmirësuar, ai ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm.</p> <p>Departamenti i PSRK për Krime të Luftës duhet të zgjerohet.</p> <p>Autoritetet e Kosovës inkurajohen që të kërkojnë mënyra për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal për hetimin e rasteve të krimeve të luftës me prioritet të lartë, në veçanti me Serbinë, ku banojnë shumë të dyshuar dhe dëshmitarë.</p>

Krimet e urrejtjes

Gjetjet	Rekomandime
<p>Zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Adresimin e Krimeve të Urrejtjes në Kosovë është larg të qenit i kënaqshëm.</p> <p>Janë bërë ndryshime në raportin policor të incidentit dhe tani ai përmban një rubrikë specifike 'krim i urrejtjes' për të identifikuar rastet potenciale të kësaj fushe.</p> <p>Diskriminimi dhe dhuna kundër minoritetëve në Kosovë ka vazhduar të jetë çështje brengosëse, në veçanti te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, dhe femrat posaçërisht.</p> <p>Mosdurimi ndaj personave lezbik, gej, biseksual, transgjinnor dhe interseksual (LGBTI) vazhdon të mbetet i përhapur gjerë dhe shumë persona LGBTI mbeten të rrezikuar nga diskriminimi dhe dhuna.</p> <p>Dy zhvillime inkurajuese në lidhje me personat transgjinnor janë vënë re:</p> <ul style="list-style-type: none">- Më 24 tetor 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës vendosi në favor të ndryshimit të emrit të Blert Morinës.- Më 2 gusht 2019, Gjykata e Apelit e Kosovës, zyrtarisht miratoi kërkesën e një qytetari transgjinnor për ndryshimin e emrit dhe shënuesin e gjinisë në Regjistrin e gjendjes civile. <p>Incidentet në lidhje me lokacionet fetare, varrezat dhe grafitit fyese shpesh raportohen kundrejt kryerësve të panjohur dhe në shumicën e rasteve mbesin të tilla sa që hetimet e incidenteve të tilla nuk priorizohen.</p>	<p>Palët e Marrëveshjes së Bashkëpunimit duhet të bëjnë përpjekje për zbatimin e dispozitave dhe për themelimin e mekanizmave të paraparë në marrëveshjen për të siguruar bashkëpunimin dhe bashkërendimin institucional në këtë fushë.</p> <p>Nevojitet më shumë sensibilizim për mundësinë që ndonjë krim të jetë i motivuar nga urrejtja apo animi.</p> <p>Nevojiten më shumë përpjekje për luftimin e mosdurimit ndaj personave LGBTI, meqë shumë prej tyre vazhdojnë të jenë të rrezikuar nga diskriminimi dhe dhuna.</p> <p>Incidentet që përfshijnë lokacionet fetare, varrezat dhe grafitit fyese duhet të hetohen më fuqishëm.</p>

Dhuna në bazë gjinore

Gjetjet	Rekomandime
<p>Krijimi i databazës për rastet e dhunës në familje është zhvillim pozitiv. Derisa Policia e Kosovës ka udhëhequr procesin e futjes së të dhënave në databazë, institucionet e tjera ende kanë mbetur prapa.</p> <p>Në nivel të policisë, përmirësime domethënëse janë vërejtur tek referimi i saktë i rasteve me pretendime të dhunës seksuale tek zinxhiri i ofruesve të shërbimeve, në veçanti tek Instituti i Mjekësisë Ligjore për ruajtjen me kohë të provave biologjike.</p> <p>Niveli i bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes policisë dhe prokurorisë dhe mungesa e personelit të trajnuar mjaftueshëm mbeten problematike.</p> <p>Derisa dënime të gjata janë shqiptuar në rastet e vrasjeve të rënda, veprat e tjera të rënda ose kanë marrë dënime të ulëta, nganjëherë edhe nën shtrirjen e paraparë, ose dënime me kusht me periudhën minimale të verifikimit prej një viti.</p>	<p>Duhet të bëhen përpjekje për miratimin e Ligjit të amandamentuar për mbrojtje nga dhuna në familje.</p> <p>Të gjitha institucionet përkatëse duhet të kontribuojnë në databazën me rastet e dhunës në familje, siç parashihet.</p> <p>Komunikimi dhe bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë duhet të përmirësohet.</p> <p>Policia duhet të jetë më mirë e trajnuar dhe e pajisur për të patur mundësinë e zbatimit të qasjes gjithëpërfshirëse të bazuar në viktimën gjatë intervistimit të viktimës dhe grumbullimit adekuat të provave teknike.</p> <p>Dispozitat e Kodit Penal të ri rreth dhunës në familje duhet të merren plotësisht parasysh nga gjykatat; kjo vlen në veçanti për faktorin rëndues të veprës penale të kryer në ambiente familjare dhe për sigurimin e arsytimit të detajuar për dënimet në të cilat faktorët rëndues tejkalohen nga faktorët lehtësues.</p>

Privatizimi dhe likuidimi

Gjetjet	Rekomandime
<p>Numri i zyrtarëve ligjorë vazhdon të jetë i pamjaftueshëm për trajtimin e më shumë se 22.000 rasteve të grumbulluara.</p> <p>Në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGJS) nuk janë mbajtur mjaftë seanca dëgjimore.</p> <p>Mjetet e veçanta në dispozicion në lidhje me kërkesat masive pothuajse nuk përdoren fare.</p> <p>Vendimi i gjyqtarit mbikëqyrës për të ricaktuar dy punonjës nga shkrimorja për të ndihmuar veçanërisht për rastet e privatizimit që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shoqërore me numër të madh të kërkesave masive është zhvillim pozitiv.</p>	<p>DhPGJS duhet të miratojë një strategji afatgjate për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara.</p> <p>DhPGJS duhet të fillojë me përdorimin e formularëve shabllon për trajtimin e kërkesave masive dhe të caktojë zyrtarë ligjorë për kryerjen e punës përgatitore përkatëse.</p> <p>Punësimi i zyrtarëve shtesë për mbështetje ligjore duhet të konsiderohet.</p>

Paneli i ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës / të drejtat pronësore

Gjetjet	Rekomandime
<p>Problemi kryesor tek rastet civile që lidhen në të drejtat pronësore është zgjatja e tepruar e procedurave për arsye të ndryshme.</p>	<p>Menaxhmenti i gjykatës duhet të ndërmerr hapat e nevojshëm për shpyrtimin e problemit të rasteve civile të grumbulluara dhe caktimin e rasteve tek gjyqtarët.</p> <p>Gjyqtarët e lëndëve civile duhet të bëjnë me dije se zgjatja e paarsyeshme e procedurave prekë të drejtën për gjykim të drejtë dhe se në ligjin për procedurën kontestimore ekzistojnë dispozita të cilat mund të aplikohen për shkurtrimin e zgjatjes së procedurës.</p>